

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Arabia Saudite godet me bomba ajrore një treg në Jemen, dhjetëra të vdekur e të plagosur - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/arabia-saudite-godet-me-bomba-ajrore-nje-treg-ne-jemen-dhjetera-te-v-dekur-e-te-plagosur/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 06:51:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 06:38:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4882219dc3a3093f4db8abfa7580aa573f0e1028e98d11caae3c4814e6c13fd1
TEKSTI	abe78678226ca582885f538b6d542e793e4f36b1d3d0f0cb9ae25c2a21eb6028
PAMJA	603056e4e1ed7ce01ac467e82de8aa436da9f0304864b5c833f65f440118f64b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	46e5528f2b1ea3d674d3a798512a44754c838b0b8b87de519c93b0e4db37df89
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c6e9ce599dcf050571ac11f5fe8a3879623b3af12e442f4fee76de6471dba328
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/46e5528f2b1ea3d674d3a798512a44754c838b0b8b87de519c93b0e4db37df89>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Edi Rama Këshilli i Sigurisë Kombëtare Inteligjenca Artificiale SHBA Lufta në Ukrainë

BOTA

Arabia Saudite godet me bomba ajrore një treg në Jemen, dhjetëra të vdekur e të plagosur

28 Shtator 2026 | 08:38

Arabia Saudite, një aleat kyç i qeverisë së njohur ndërkombëtarisht të Jemenit, kreu të paktën dy sulme ajrore në një treg në sektorin jugperëndimor të vendit më të varfër në Gadishullin Arabik të dielën, njoftuan rebelët Huthi, duke përmendur dhjetëra të vdekur dhe të plagosur.

Mediat vendase raportuar më parë shtatë të vdekur dhe 40 të plagosur, përfshirë pesë fëmijë.

Më vonë, zëdhënësi i Huthit për çështjet ushtarake, Yahya Sharia, foli për gati 50 viktima, pa bërë dallim midis të vdekurve dhe të plagosurve, duke akuzuar forcat ajrore saudite për kryerjen e "dy bastisjeve kundër një tregu" në periferi të Taizit.

"Ky gjak që u derdh padrejtësisht" nuk do të mbetet pa "pasoja" për Arabinë Saudite, theksoi Sheriati.

Qyteti i madh i Taizit, i kontrolluar nga forcat qeveritare, ndodhet në një nga frontet kryesore të luftimeve me rebelët.

Pamjet e transmetuara nga Masira tregojnë makina me xhama të thyer dhe depo të dëmtuara, si dhe mallra të shpërndara përreth.

Pas disa vitesh qetësie relative, Jemeni u zhyt përsëri në luftë në korrik, duke u bërë një front i ri në konfliktin më të gjërë në Lindjen e Mesme.

Luftimet i vënë përballë Huthitët, të cilët kontrollojnë kryeqytetin Sanaa dhe tani bregdetin e Detit të Kuq të Jemenit, kundër forcave të qeverisë së njohur ndërkombëtarisht. Kjo e fundit, e vendosur në Aden, kontrollon pjesën më të madhe të pjesëve jugore dhe lindore të vendit, të cilat janë po aq të gjera, por me shumë më pak banorë.

Konflikti u intensifikua në shtator, kur rebelët pushtuan brenda pak 24 orësh, duke nisur një sulm vdekjeprurës, të gjithë vijën bregdetare të Jemenit në Detin e Kuq, duke konsoliduar kontrollin e tyre mbi ngushticën strategjike të rëndësishme Bab el-Mandeb, e cila lidh Evropën me Azinë nëpërmjet Kanalit të Suezit.

Ata njoftuan gjithashtu vendosjen e një bllokade detare ndaj Arabisë Saudite, eksportuesit më të madh të naftës bruto në botë, dhe shënjestruan infrastrukturën e naftës dhe anijet cisterna të mbretërisë, si dhe kryeqytetin Riad, për herë të parë në vite.

LAJMI I FUNDIT

08:37 Mbërrin Rama në Pallatin e Brigadave, nis mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (VIDEO)

08:28 Orteku godet një grup alpinistësh në Himalaje, 2 të vdekur dhe dhjetëra të zhdukur në Nepal

08:26 Kuvendi i Kosovës mblidhet sot në seancën e radhës plenare, në rend dite votimi i deklaratës për Gjykatën Speciale

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

08:20 Një javë pa ushqim dhe karburant, shpëtohen 260 emigrantë në Atlantik

08:19 Ndahen çmimet MTV VMA 2026, Madonna dhe Taylor Swift triumfojnë në natën e madhe të muzikës

08:14 Kush janë anëtarët e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (EMRAT)

TESTIM

Të shtunën, monarkia e fuqishme e Gjirit njoftoi se kishte kapur dy dronë “të nisur nga organizata terroriste paraushtarake Houthi në drejtim të zonës së Riadit”.

Në këtë sfond, shkollat në kryeqytetin saudit, Riad, njoftuan të dielën, se do të funksionojnë me mësim në distancë për një javë.

Pavarësisht sulmeve ajrore të përditshme saudite dhe luftimeve të vazhdueshme në terren, forcat e qeverisë së njohur ndërkombëtarisht të Jemenit dhe Riadit nuk kanë arritur t'i detyrojnë Huthit të tërhiqen dhe thirrjet e tyre për ndihmë ndërkombëtare deri më tani nuk janë marrë parasysh.

Të shtunën, Huthitët akuzuan forcat ajrore të Arabisë Saudite për kryerjen e 27 bastisjeve në zona të ndryshme të vendit.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA
Orteku godet një grup alpinistësh në Himalaje, 2 të vdekur dhe dhjetëra të zhdukur në Nepal
Ekipet e shpëtimit kanë nxjerrë dy trupa nga vendi i një orteku që goditi një grup alpinistësh që po bënë kamping në pjesën nepaleze të...
08:28 | 28/09/2026

BOTA
Një javë pa ushqim dhe karburant, shpëtohen 260 emigrantë në Atlantik
Roja bregdetare e Mauritanisë ka njoftuar se ka shpëtuar rreth 260 emigrantë , përfshirë 17 fëmijë, të cilët ishin në rrezik në det të dielën....
08:20 | 28/09/2026

BOTA
Ndahen çmimet MTV VMA 2026, Madonna dhe Taylor Swift triumfojnë në natën e madhe të muzikës
Çmimet MTV Video Music Awards 2026, të drejtuara nga Snoop Dogg, u zhvilluan të dielën në Peacock Theater në Los Angeles. Disa nga artistët më...
08:19 | 28/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms: